



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 6.06.2019

Dokument parlamentar

(Komision për dhënie mendimi)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN,
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.157/2013, “PËR
MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 5.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Roland Xhelilaj.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent Znj. Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, objektivat dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit

Projektligji i propozuar, synohet përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi i FATF, adreson problematikat e sipërcituara dhe ka për qëllim parësor mbrojtjen e sistemit financiar dhe të ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen, sigurinë si dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të fushës. Në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm synohet:

- Zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit;
- Parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre;
- Zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrim të parave/financim terrorizmi.

Rekomandimet e Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës dhe problematikat e konstatuara.

Sistemi Shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të Raundit të 5-të kryer nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës si struktura rajonale vlerësuese lidhur me përputhshmërinë me rekomandimet e FATF-së (*Financial Action Task-Force*). Këto rekomandime janë botërisht të pranuar dhe në rastet e mos ndjekjes dhe zbatimit, aplikohen mekanizma ndëshkimi. Gjithashtu rekomandimet e sipërcituara janë një detyrim që rrjedh nga neni 13 i Konventës së KiE, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646, datë 27.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës, “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”.

Në përfundim të vlerësimit nga Komiteti MONEYVAL, është konstatuar se pavarësisht zhvillimeve të konsiderueshme ligjore, vijon të ketë boshllëqe në kuadrin ligjor që rregullon sanksionet financiare specifike të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit.

Kështu, legjislacioni aktual në fuqi ligji nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, nuk përcakton veprimet që duhen kryer nga subjektet raportuese në bazë të urdhrat të bllokimit. Përkufizimi i fondeve dhe pasurive nuk përfshin pasuritë e trupëzuara dhe të patrupëzuara, nuk përfshin shprehimisht burimet ekonomike duke bërë referencë vetëm tek depozitat bankare. Gjithashtu, nuk parashikohet nëse mekanizmi i bllokimit do të shtrihet tek fondet, të cilat nuk janë në pronësi, por janë nën kontrollin e personave të shpallur. Ligji aktual, nuk detyron zbatimin e drejtpërdrejtë të sanksioneve

të OKB-së kundër financimit të terrorizmit. Mungojnë përcaktimet ligjore lidhur me detyrimin e subjekteve raportuese për të kryer veprime të mëtejshme si p.sh bllokimit pa vonesë, si dhe mekanizmat bllokues për rastet e agjencive ligj zbatuese. Nuk parashikohet ndonjë detyrim për ndjekjen e procedurave dhe formularët standard, siç janë miratuar nga Komitetet relevante si dhe nuk ka ndonjë parashikim ligjor të posaçëm që cakton procedurat për të kërkuar nga shtete tjera zbatimin e masave në kuadër të mekanizmit të ngrirjes, dhe sigurimin e informacionit identifikues.

Projektligji i propozuar, synon përmbushjen e këtyre rekomandimeve, adresimin e problematikave dhe mundësimin e mbrojtjes së sistemit financiar nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, forcimin e integritetit të sistemit parandalues në vend, zvogëlimin e mundësisë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit nëpërmjet politikave koherente, parandalimin e hyrjes në vendin tonë të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar etj.

Përmbajtja e projektligjit

Projektligji përbehet nga 12 nene gjithsej të cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë si vijon:

- Në nenin 1 të projektligjit zgjerohet koncepti i bllokimit të përkohshëm në përputhje me kriteret e vendosura nga rekomandimet e FATF-së, për të siguruar që masat e marra në rast bllokimi/sekuestrimi përfshijnë edhe ndalimin e dhënies së shërbimeve financiare dhe se aplikohet ndaj të gjitha llojeve të pasurive. Me këtë ndryshim synohet gjithashtu që fondet dhe pasuritë e tjera të përfshijnë, shprehimisht, burimet ekonomike, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.5, shkronja “b”).
- Në nenin 2 të projektligjit në pikën 4 të neit 6 shtohen masat që merren edhe për fondet dhe pasuritë e tjera. Në nenin 3 të projektligjit bëhen ndryshim dhe shtesa në nenin 10 të ligjit bazë, duke shtuar detyrimin që fondet dhe asetet e personave apo enteve të shpallura të bllokohen pa njoftim paraprak;
- Neni 4 I projektligjit shton një nen të ri 10/1, për të garantuar zbatimin pa vonesë (që tanimë interpretohet si çështje orësh dhe që duhet të gjejë zbatim menjëherë) të sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në lidhje me terrorizmit dhe/ose financimin e tij, element ky që është vlerësuar ende problematik nga Komiteti Moneyval.
- Në nenin 5 të projektligjit mundësohen disa ndryshime dhe shtesa në nenin 14 të projektligjit duke mundësuar kësisoj, shkurtimin e afateve të zbatimit të rezolutave, saktësimin e detyrimit për nxjerrjen e urdhër bllokimit nga ministri përgjegjës për financat, nëse ka të dhëna për ekzistencën e tyre brenda vendit, saktësohen procedurat dhe standardet që do të ndiqen, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.5, shkronja “b”).
- Në nenin 6 të projektligjit bëhen disa shtesa në nenin 15 të ligjit duke zgjeruar konceptin e përfshirjes së personave të dyshuar si dhe sqarohet procedura lidhur me pikën 2, të nenit 5, të ligjit. Ndërkohë në nenin 7 të projektligjit propozohen disa ndryshime në nenin 16 të ligjit duke hequr diskrecionin për nxjerrjen e urdhrin nga ministri i ngarkuar, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.4) si dhe

duke shtuar afatin e urdhrit të bllokimit, me synim që të paraprihet çdo lloj problematike apo situatë sipas të cilës vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave nuk miratohet në kohë, duke rrezikuar lirimin e fondeve të bllokuara.

- Në nenin 8 të projektligjit, propozohen disa ndryshime dhe shtesa në nenin 18 të ligjit me synim unifikimin e afateve për njoftim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së sipas kërkesave të rezolutave të komiteteve përkatëse, ndjekjen e procedurave dhe përdorimin e formularëve standarde, siç janë miratuar nga Komitetet përkatëse, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF (kriteri 6.1 shkronja “d”), mundësimin e informacionit identifikues dhe informacionit të posaçëm që mbështet shpalljen, kur i kërkohet një vendi tjetër njohja e masave të nisura nën mekanizmin e bllokimit, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.2, shkronja “e”).
- Në nenin 9 të projektligjit propozohen disa ndryshime në nenin 21 duke shkurtuar afatet e verifikimeve, nisur nga konstatimi për veprime jo në kohë, për implementim të sanksioneve, të evidentuara në Raportin e Moneyval, ndërsa në nenin 10 e 11 saktësohen procedurat e lejimit të shpenzimeve si dhe vendosen procedurat për paraqitjen pranë komiteteve përkatës të OKB-së, të kërkesave për heqje nga lista të personave apo enteve të shpallur, sipas regjimit të sanksioneve të OKB-së, të cilët, sipas vlerësimit të vendit nuk plotësojnë kriteret për shpallje, në përputhje me rekomandimin 6, të FATF-së (kriteri 6.6, shkronja “a”).
- Neni 12 përcakton hyrjen në fuqi të tij 15 ditë pas fotimit në fletoren zyrtare.

IV. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, shpjegoi se, projektligji objekt shqyrtimi është paraqitur në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës. Ai vjen si një paketë së bashku edhe me disa ligje të tjera të cilat gjithashtu adresojnë rekomandimet e kësaj strukture lidhur me masat që duhet të ndërmerren vendi ynë në kundër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, reduktimit të informalitetit, transparencës etj.

Objektivat e projektligjit të propozuar konsistojnë në:

- Vijimin e përafrimit të plotë të legjislacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar dhe plotësimi i tij duke mundësuar zbatimin nga Republika e Shqipërisë të detyrimit që rrjedh nga neni 13 i Konventës nr. 198 të KiE, “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit” ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646 datë 27.11.2006.
- Parandalimi i hyrjes së fondeve në mbështetje të terrorizmit dhe zbulimi i pasurive dhe fondeve të mbajtura nga personat e shpallur dhe ndalimet;

- Implementimi dhe zbatimi i sanksioneve financiare specifike në përputhje me procedurat dhe standardet e Metodologjisë së FATF;
- Bllokimi pa njoftim paraprak I fondeve dhe pasurive e personave të shpallur, përcaktimi i mekanizmave për identifikimin e subjekteve potencial për shpallje sipas kriterëve të Rezolutave, mundësimin e ndjekjes së procedurave dhe formularëve standarde për listim të miratuara nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit;
- Implementimi pa vonesë i sanksioneve financiare specifike dhe vendosja e procedurave të heqjes nga lista dhe të zhbllokimit të fondeve dhe pasurive të subjekteve të cilët nuk plotësojnë/nuk plotësojnë më, kriteret për shpallje;

Projektligji i propozuar, synon mbrojtjen e sistemit financiar nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, forcimin e integritetit të sistemit parandalues në vend, zvogëlimin e mundësisë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit nëpërmjet politikave koherente, parandalimin e hyrjes në vendin tonë të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar etj.

Si struktura përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji janë përcaktuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave si dhe subjektet dhe personat e përcaktuar në nenet 7, 8, 9 dhe 10 të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, theksuan rëndësinë e këtij projektligji në kuadër të masave që Qeveria Shqiptare po ndërmerr së bashku me gjithë paketën e projektligjeve lidhur me masat që duhet të ndërmerren vendi ynë në kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

V. Përfundime dhe ndryshimet e projekt ligjit

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar si tejet pozitive mundësinë që krijohet përmes këtij projektligji, në përmbushjen e rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim nen për nen dhe në tërësi dhe i përcjell komisionit përgjegjës këto rekomandime:

- Përpara nenit 1, rekomandohet të shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje:

“Neni 1

Kudo në ligj fjalët “ministri i financave” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për financat, fjalët “ministri i punëve të jashtme” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për punët e jashtme”, fjalët “Ministri i Brendshëm” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet e brendshme”, fjalët “Ministri i Drejtësisë” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për drejtësinë.”

- Në nenin 2 të projektligjit, rekomandohet që fjalët “Pas fjalisë së parë, në pikën 4, të nenit 6, shtohen” të zëvendësohen me fjalët “Në fund të pikës 4 të nenit 6, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:”
- Në nenin 4 të projektligjit, rekomandohet që të vlerësohet ruajtja e drejtë e balancës mes cenimit të së drejtës së përdorimit dhe gëzimit lirisht të pronës dhe të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të individit me atë të interesit publik. Gjithashtu rekomandohet edhe vendosja e titullit të nenit 10/1 “Zbatimi i menjëhershëm i sanksioneve”.

RELATOR

Roland XHELILAJ

KRYETAR

Arben AHMETAJ